



RECON

RE-valuation of Cultural-Heritage,
Knowledge and Opportunity Network



KOHEZIONI MES ARTIT BASHKËKOHOR DHE TRASHËGIMISË KULTURORE FILMIKE

U mbyll me sukses punëtorja "Kohezioni mes Artit Bashkëkohor dhe Trashëgimisë Kulturore Filmike", organizuar nga Komuna e Termolit (rajoni i Molizes) në Circolo della Vela, më 28 dhe 29 shtator 2022. Dy ditët, kushtuar restaurimit të trashëgimisë historike kinematografike dhe përmirësimit të teknologjive moderne dhe platformave dixhitale për rikuperimin dhe katalogimin e materialit filmik arkivor, panë praninë e një paneli të pasur ekspertësh dhe artistësh nga Italia, Shqipëria dhe Mali i Zi. Mes pjesëmarrësve në evente, ishin edhe katër artistët e përzgjedhur nga projekti përmes një thirrjeje të hapur, të nisur majin e kaluar, për rezidencën artistike dhe krijimin e një filmi dokumentari dhe një videoinstalacioni. Me këtë rast artistët prezantuan për herë të parë veprat e tyre kinematografike, të realizuara duke përdorur ekskluzivisht materiale arkivore që i përkasin koleksioneve filmike të Kinematekës së Malit të Zi dhe Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit në Shqipëri. Punëtorja përfundoi me një seancë dialogu ndërmjet partnerëve të projektit dhe palëve të interesuara të fushës.



RECON-NETTING KOHEZIONI MIDIS TRASHËGIMISË FILMIKE HISTORIKE DHE FORMAVE TË REJA TË ARTIT

Ambienti historik i Castello Svevo të Termolit priti, të premten, më 30 shtator 2022, çeljen e ekspozitës filmike "RECON-NETTING Kohezioni ndërmjet trashëgimisë historike filmike dhe formave të reja të artit", promovuar dhe organizuar nga Komuna e Termolit. Ekspozita, e cila u zhvillua nga data 1 tetor deri më 7 tetor 2022, u mundësoi artistëve të rinj të përzgjedhur majin e kaluar falë thirrjes së hapur të nisur nga partnerët shqiptarë dhe malazezë, të ekspozojnë



dhe shfaqin veprat e tyre kinematografike: "The Echo" nga Dario Haruni, "Pse Kështu" nga Una Jovovic, "Një poezi në ditë e mban luftën larg" nga Tamara Pavicevic dhe "Limonë dhe Portokaj" nga Enxhi Noni. Punimet kinematografike janë realizuar duke përdorur materiale arkivore që ruhen në Arkivin Qendror të Filmit në Shqipëri dhe në Kinematekën e Malit të Zi. Artistët prezantuan edhe një sërë imazhesh fotografike të marra nga filmat e realizuar.



KOMITETI DREJTUES NË TERMOLI

Komiteti Drejtues RECON, i përkushtuar për prezantimin e statusit të aktiviteteve të projektit, u zhvillua në Termoli, Molise, më 30 shtator 2022, me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve të projektit. Pas një pjese fillestare hyrëse, secili partner prezantoi ecurinë e tij dhe gjendjen e të gjitha aktiviteteve të kryera deri më tani. Partneriteti diskutoi edhe për rezultatet dhe objektivat që do të arrihen në të ardhmen.



E drejta e autorit © 2022 | Projekti RECON

Ju e kemi marrë këtë mesazh sepse jeni abonuar në një nga listat e postimeve të partnerëve RECON. Nëse nuk dëshironi të merrni email të mëtejshëm nga ne, mund të anuloni abonimin tuaj në listën e postimeve duke iu përgjigjur këtij e-mail